

RAPORT

**MBI ZBATIMIN E LIGJIT TË
DEKRIMINALIZIMIT NË SHQIPËRI**



MBI ZBATIMIN E LIGJIT TË DEKRIMINALIZIMIT NË SHQIPËRI

Mbështetur nga Fondacioni Westminster për Demokraci

Përgatiti: Eduard Halimi, Ekspert i të drejtës ndërkombëtare private dhe të drejtës kushtetuese

Tiranë, shtator 2023

Klauzola e përgjegjesisë:

Ky raport është hartuar nga Halimi Law and Tax, me mbështetjen dhe udhëzimet e Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD). Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban. Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Westminster Foundation for Democracy (WFD)

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është një organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për forcimin e demokracisë në mbarë botën. Për më shumë se tridhjetë vjet WFD ka ndihmuar në mënyrë aktive demokracitë të forcohen, në mënyrë që liria dhe prosperiteti të lulëzojnë. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar në bërjen e sistemeve politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme.



PËRMBAJTJA

I. HISTORIK I SHKURTËR.....	4
II. LIGJI DHE AKTET NËNLIGJORE TË MIRATUARA	9
III. ZBATIMI I DEKRIMINALIZIMIT	11
IV. PROBLEMATIKAT DHE MANGËSITË	21
V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	25
VI. BIBLIOGRAFIA	28
VII. RRETH EKSPERTIT	30

I. HISTORIK I SHKURTËR

1. Deri në zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, sistemi zgjedhor në Shqipëri ishte mazhoritar me 100 zona zgjedhore ku deputetët zgjidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë, i korrigjuar me sistemin proporcional ku 40 deputetë zgjidheshin mbi bazën e numrit të votave që kishin marrë partitë politike. Në vitin 2008, dy forcat politike kryesore arritën një marrëveshje për të ndryshuar sistemin zgjedhor në proporcional rajonal. Kjo nënkuptonte që Shqipëria ishte e organizuar në 12 zona zgjedhore që përputheshin me organizimin territorial të qarqeve, ku deputetët zgjidhen nga përfaqësimi proporcional i listave të mbyllura me një prag prej 3% për partitë politike dhe 5% për koalicionet.

2. Sistemi proporcional rajonal, i aplikuar për herë të parë në vitin 2009, forconte në mënyrë domethënëse rolin e kryetarit të partisë në përgatitjen e listave të kandidatëve për deputetë, gjithëaq duke rritur përgjegjësinë e tij për të përzgjedhur kandidatë që përmirësonin cilësinë e klasës politike, dhe përfaqësuesve të popullit në Kuvendin e Shqipërisë. Fitorja për herë të dytë e zgjedhjeve nga koalicioni qeverisës i të djathtës në zgjedhjet e 28 qershorit 2009, nxiti partitë humbëse që të kërkonin mënyra të tjera alternative për të siguruar më shumë vota.

3. Në zgjedhjet vendore të vitit 2011 dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, u evidentua se disa kandidatë për kryebashkiakë dhe deputetë kishin një të shkuar me rekorde kriminale. Në të shumtën e rasteve, kishim të bënim me individë, të cilët kishin emigruar në fillimin e viteve 90', ku mungonin informacionet për angazhimet që kishin pasur atje, për t'u kthyer më pas në Shqipëri, ku ishin shndërruar në biznesmenë lokalë, me influencë të madhe në zonat e tyre. Angazhimi i tyre në politikë lidhej vetëm me realizimin e interesave ekonomike të caktuara. Mungesa e të dhënave për rekordet kriminale nga shtetet e huaja në regjistrin e gjendjes gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri, sillte që në verifikimet paraprake këta individë rezultonin "të padënuar".

4. Certifikata "e pastër" gjyqësore iu mundësonte që të zhvillonin aktivitetin ekonomik, duke përfituar kontrata publike. Fillimisht, angazhimi politik i këtyre individëve do të materializohej nëpërmjet mbështetjes së kandidatëve të forcave politike të caktuara, nëpërmjet të ashtuquajturës "*kontratë e politikës me krimin*". Ky fenomen i ndodhur në vende të tjera po zhvillohej edhe në Shqipëri. Thelbi i kësaj "kontrate" ishte i thjeshtë: ti më ndihmon mua me forcën, paratë, influencën, gjatë procesit të zgjedhjeve dhe unë në këmbim pasi fitoj të jap kontrata publike, leje, liçenca dhe emërimet nepotike në administratën publike. Të pakënaqur nga ky rol në plan të dytë, më pas këta individë vendosen të përfshiheshin drejtpërdrejtë në listat e kandidatëve, duke e parë më të leverdisshme këtë nivel të ri marrëdhënieje me klasën politike.

5. Të vetëdijshëm për të shkuarën e tyre dhe të shqetësuar për reagimin që mund të prodhonte në opinionin publik, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, këta individë u vendosën në pjesën e listave jofituese të kandidatëve për deputetë ose në raste të caktuara, ata ishin kandidatë të partive politike që nuk ia kishin dalë më herët të siguronin një mandat deputeti. Duke patur

parasysh detyrimin e kriterit zgjedhor (1 në 3 kandidatët e parë të ishin zonja), ata u vendosën poshtë tyre. Por, kjo skemë do të zbardhej shpejt. Rastet e para erdhën nga zona zgjedhore në pjesën veriore të Shqipërisë, ku e majta nuk fitonte prej vitesh.

6. Kalkulimi i listave ku zonjat jepnin dorëheqje të pajustificueshme për t'i lënë vendin kandidatëve të tjerë shpjegonte sa mekanizimin e përdorur, po aq edhe detyrimin për të zbatuar kontratën me politikën dhe hyrjen e tyre drejtpërdrejtë dhe detyrimisht në sallën e Parlamentit. Rasti i parë i këtij mekanizmi do të shfaqej pikërisht në qarkun e Lezhës dhe më pas do të përsëritej në zona të tjera zgjedhore¹, ku dorëheqja e kandidatëve fitues, do të sillte në Kuvend deputetë, të panjohur për opinionin e gjërë publik për ndonjë lidhje me politikën apo kontributet partiake, por qartazi për ndikimin e tyre në rritjen e votave të forcës së tyre politike dhe që dyshoheshin për rekorde të tmerrshme kriminale. Kështu nëse në disa vende, politika i shpallte luftë krimit, e diku tjetër i shkelte syrin, në Shqipëri po ndodhte ajo që nuk ishte parë deri në atë kohë, politika dhe krimi kishin lidhur kontratë dhe ishin bërë një në parlament, administratë, kompani publike etj.

7. Opozita parlamentare, e përfaqësuar kryesisht nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, qysh në fillim të legjislaturës 2013–2017, filloi denoncimin e individëve me rekorde kriminale, të cilët me mbështetjen e kryeministrit Edi Rama dhe Partisë Socialiste, ia kishin dalë të penetronin në zyrat e shtetit, duke u zgjedhur deputetë, kryetarë bashkie, këshilltarë lokalë apo duke u emëruar në funksione të larta publike. Denoncimet e drejtpërdrejta të deputetëve të PD-së sollën një reagim të fortë nga individët e atakuar të mazhorancës, të cilët përveç kërcënimeve verbale, arritën në Maj – Korrik 2014, edhe në akte dhune fizike në ambientet e brendshme të Kuvendit të Shqipërisë.

8. Ligjvënës të mazhorancës me rekorde kriminale, dhuna verbale dhe fizike ndaj opozitës, refuzimi për ngritjen e komisioneve hetimore dhe moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që i jepnin të drejtë kërkesave për hetim parlamentar, çuan në vendimmarrjen e Partisë Demokratike për të bojkotuar plotësisht jetën parlamentare dhe institucionale, duke e zhvendosur aksionin opozitar kryesisht në protesta. Kusht i panegociueshëm për rikthimin e opozitës në Kuvend dhe rifillimin e jetës parlamentare normale ishte dekriminalizimi i Parlamentit dhe administratës publike. Në këtë kauzë, Partia Demokratike fitoi një aleat, pa të cilin vështirë se do të kishte mundur t'ia dilte, faktorin ndërkombëtar.

9. Parlamenti dhe Komisioni Evropian, nëpërmjet Delegacionit të BE-së në Tiranë, dhe Departamenti i Shtetit, nëpërmjet Ambasadës Amerikane në Tiranë, ishin ndër zërat më aktivë në denoncimin dhe thirrjet e përsëritura ndaj politikës për të larguar nga jeta institucionale të individëve me rekorde kriminale. Në raportin e DASH për vitin 2015 për Trafikimin e Qënieve Njerëzore thuej shprehimisht se: *“Një anëtar i Parlamentit ka qenë më parë i dënuar për krime të lidhura me trafikimin.”* Ambasada e SHBA-së në Tiranë *“vlerëson si të turpshme që ka një anëtar*

¹ ISP, Dekriminalizimi: Gjendja, Problematika dhe Pritshmëritë, Kreu 2.5, fq. 26-30

të parlamentit shqiptar me dënime për trafikimin e njerëzve. Shqiptarët kanë të drejtë të kenë përfaqësues të zgjedhur me dinjitet dhe standarde të larta, jo kriminelë.”.

10. Shqetësimi të opozitës parlamentare, të mbështetur nga faktori ndërkombëtar, do t'i bashkohej edhe media e shoqëria civile. Gjithnjë e më shumë artikulohej problematika e individëve me rekorde kriminale në politikë dhe nevoja për një pastrim të thellë të Parlamentit dhe administratës publike nga këta individë. Madje në një rast të rrallë për jetën e vendit, thirrjeve për dekriminalizimin e politikës dhe refuzimin me votë të qytetarëve ndaj këtyre individëve iu bashkua edhe Kisha Katolike, nëpërmjet organit më të lartë vendimmarrës të saj Konferencës Ipeshkvnore.² Përmasat e reja që mori çështja e individëve me rekorde kriminale në politikë u dukën veçanërisht në deklaratat e europarlamentarëve se nuk mund të ketë progres në integrimin evropian, pa zgjidhur këtë çështje.

11. Pikërisht ndërhyrja aktive e deputetëve të Parlamentit Evropian, do të detyronte Partinë Socialiste dhe Partinë Demokratike që të miratonin një rezolutë të përbashkët në 24 dhjetor 2014. Në thelb, rezoluta parashikonte rikthimin e opozitës në jetën parlamentare, si dhe adresimin e çështjeve që kishin të bënin me ngritjen e komisioneve hetimore dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Por, ajo që ishte më e rëndësishmja në këtë rezolutë ishte pikërisht pika 3, e cila parashikonte se: *“Opozita dhe mazhoranca qeverisëse angazhohen të punojnë së bashku me konsensus, me ndihmën e Bashkimit Evropian, për çështjen e individëve me rekorde kriminale, të cilët mbajnë një post publik ose kërkojnë të zgjidhen apo të emërohen në një të tillë, bazuar në standardet europiane dhe me asistencën e Komisionit të Venecias.”.*

12. Mbi bazën e kësaj rezolute, më 15 janar 2015, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të kërkonte krijimin e një komisioni të posaçëm parlamentar për zgjidhjen e problematikës për çështjen e individëve me rekorde kriminale. Një muaj më vonë, Kuvendi do të miratonte vendimin nr. 32/2015 për ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar, i cili duhet të adresonte çështjet e trajtuara në rezolutën e 24 dhjetorit. Komisioni do të kishte një përbërje bipartizane me 4 përfaqësues të mazhorancës (T. Balla, U. Manja, A. Subashi, S. Braho) dhe 3 përfaqësues të opozitës (O. Bylykbashi, E. Halimi, G. Strazimiri). Drejtimi i komisionit iu besua deputetit të PD-së, z. Oerd Bylykbashi. Komisioni kishte një afat 3-mujor, dhe produktet e tij duhet të miratoheshin nga Kuvendi brenda datës 30 qershor 2015.³

13. Komisioni i Posaçëm Parlamentar e filloi veprimtarinë e tij më 25 shkurt 2015, për ta përmbyllur rreth 10 muaj më pas, në datën 14 dhjetor 2015. Gjatë kësaj kohe, ky komision zhvilloi 10 mbledhje. Megjithëse, produkt i një vullneti konsensual të materializuar në rezolutën e 24 dhjetorit 2014 dhe vendimi nr. 32/2015 i Kuvendit të Shqipërisë, diskutimet në mbledhjet e para të komisionit treguan se palët të cilave mendohej se i kundërdrejtohej kishin vepruar më shumë nën

² ISP, Dekriminalizimi: Gjendja, Problematika dhe Pritshmëritë, Kreu 2.4, fq. 22-26

³ Të gjitha informacionet lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar kanë për referencë praktikën parlamentare që ndodhet në Arkivën e Kuvendit, e cila na u vu në dispozicion nga Kuvendi me shkresën nr. 1801/1 prot., datë 08.06.2023, në kuadër të përgatitjes së këtij raporti;

detyrimin e faktorit ndërkombëtar, sesa të bindur për nevojën e madhe që kishte politika për t'u çliruar nga individët me rekorde kriminale. E vetmja dakordësi që u duk se palët arritën që në fillim ishte kërkesa për t'u asistuar nga ekspertiza e Komisionit të Venecias, të mbështetur edhe nga Delegacioni i BE-së dhe Ambasada Amerikane.⁴

14. Veprimtaria e Komisionit zhvillohej në një kontekst të veçantë politik pasi më pak se katër muaj, do të zhvilloheshin zgjedhjet lokale të 21 qershorit 2015. Prandaj, deputetët e opozitës kërkonin me insistim që të miratohej sa më shpejt paketa e plotë ligjore për dekriminalizimin, në mënyrë që qytetarëve t'u ofrohej kandidatura të pastra, me integritet të dëshmuar, për kryetarë bashkie dhe këshilltarë bashkiakë.⁵ Mbledhja e tretë dhe e katërt e Komisionit do të shënonin dy zhvillime të rëndësishme. E para, Partia Demokratike do të prezantonte zyrtarisht platformën e saj për dekriminalizimin⁶ dhe e dyta, Grupi Parlamentar i PD-së do të depozitonte një projektligj që përmbante dy amendamente të Kodit Zgjedhor, që në thelb sanksiononin ndalimin e zgjedhjes së individëve të dënuar apo nën hetim/gjykim për krime shumë të rënda.⁷

15. Në hartimin e kësaj platforme u angazhuan ekspertët më të mirë të opozitës parlamentare, dhe pati një mbështetje thelbësore nga ekspertët italianë, të cilët e kishin kaluar më herët këtë fazë në vitet 80', për të kulmuar me miratimin e ligjit "Severino". Diskutimet më të gjata kanë patur të bëjnë me "testin", që bëhej për të kuptuar efektivitetin e kësaj nisme, dhe se sa do të rezultonte ajo e suksesshme në praktikë. Rregulli që synohej të ndiqej ishte i ngjashëm me procedurën e marrjes së një vize në ambasadën amerikane dhe britanike. Individit deklaronte historikun e rekordeve të tij kriminale, dhe nëse më pas rezultonin të dhëna të rreme apo të fshehura, atëherë kishte sanksione administrative dhe penale. Kjo qasje praktike e deputetëve të opozitës me ambasadorët e SHBA-ve dhe BE-së, bëri që ata ta përkrahnin prej fillimi në fund këtë logjikë, që vazhdon të funksionojë edhe sot. Një qasje e ngjashme ishte përdorur edhe për miratimin e ligjit nr. 9614, datë 21.09.2006 "Për Certifikatat Elektronike të Gjendjes Gjyqësore", që hoqi nga përdorimi dëshmitë fizike të penalitetit, të cilat kishin krijuar kosto, ngarkesë dhe korrupsion në administratën publike.

16. Propozimet e PD-së nuk gjetën dakordësinë e mazhorancës, dhe si rrjedhojë në zgjedhjet e 21 qershorit 2015, nuk u bë e mundur që listat e kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshilltarë bashkiakë t'i nënshtroheshin filtrit të dekriminalizimit. Në disa raste, opozita, media dhe shoqëria civile denoncoi kandidatë të caktuar të mazhorancës për të shkuarën e tyre problematike, veçanërisht në periudhën kur kishin jetuar jashtë vendit. Megjithëse afati fillestar i veprimtarisë ishte caktuar 31 maj 2015, dhe produktet e tij duhet të miratoheshin brenda datës 30 qershor 2015, Komisioni nuk zhvilloi mbledhje të tjera në periudhën para-zgjedhore. Gjatë kësaj kohe, Komisioni i Venecias përcolli raportin paraprak "Për përjashtimin e shkelësve të ligjit nga Parlamenti", të miratuar nga sesioni plenar nr. 103-të, në datat 19 – 20 qershor 2015. Ndërkohë,

⁴ Proçesverballi i datës 25 shkurt 2015 i Komisionit të Posaçëm;

⁵ Po aty, diskutimi i deputetit E. Halimi;

⁶ Proçesverballi i datës 26 mars 2015 i Komisionit të Posaçëm;

⁷ Proçesverballi i datës 27 prill 2015 i Komisionit të Posaçëm;

me kërkesë të kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së, z. Edi Paloka, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit deri më 31 dhjetor 2015.

17. Me fillimin e legjislaturës së re, Grupi Parlamentar i PD-së depozitoi në datën 7 shtator 2015, projektligjin për dekriminalizimin së bashku me amendamentet kushtetuese. Ndryshe nga propozimet e mëparshme të bëra të ditura në kuadër të prezantimit të plaformës të dekriminalizimit, projektligji aktual nuk parashikonte ndërhyrje në një sërë aktesh të tjera ligjore, por ishte një akt unik. Në mbledhjen e parë të zhvilluar pas zgjedhjeve vendore të 21 qershorit, hartuesit e projektligjit shpjeguan se modeli referencë ishte ligji italian “Severino”, i miratuar në vitin 2012, në kuadër të luftës kundër përfshirjes së mafias në politikë.⁸ Nëntë ditë pas paraqitjes së propozimit të PD-së, qeveria do të miratonte një projektligj, i cili megjithëse në shumë aspekte ishte thujse i ngjashëm me versionin e opozitës, kishte treguar kujdes të veçantë për të evituar termin “dekriminalizim”.

18. Përfaqësuesve të opozitës dhe mazhorancës iu deshën rreth dy muaj kohë, për të ardhur në mbledhjen e datës 20 nëntor, ku palët ishin dakordësuar për një projektligj të ripunuar që do të kishte titullin “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe që ushtrojnë funksione publike*”. Projektligji i ripunuar ishte në masën më të madhe i njëjtë me propozimin fillestar të PD-së. Dy çështje, për të cilat ka pasur jo pak debat, që ishin hequr nga versioni i ripunuar i projektligjit, ishte heqja e ndalimit të zgjedhjes apo emërimit të funksionarëve publikë që ishin përdorues të lëndëve narkotike dhe për ata deputetë që iu ishte hequr mandati me vendim të Gjykatës Kushtetuese për shkak se kishin abuzuar me mandatin e deputetit, duke marrë fonde publike, ndërkohë që mbanin mandatin e deputetit. Deputetët e PD-së këmbëngulën shumë që këto rregullime të përfshiheshin në projektligj⁹, por pa arritur të gjejnë dakordësinë e mazhorancës.

19. Tre mbledhjet e datës 20 nëntor, 23 nëntor dhe 14 dhjetor do të rezultonin më produktivet ku do të miratoheshin amendamentet kushtetuese dhe projektligji i posaçëm për dekriminalizimin. Paketa e plotë do t’i paraqitej Kuvendit në datën 17.12.2015, e cila me 132 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, do të miratonte ndryshimet kushtetuese me ligjin nr. 137/2015, dhe dekriminalizimin e funksionarëve publikë me ligjin nr. 138/2015. Në seksionin vijues do të analizojmë më në detaje rregullimet e këtyre akteve. Fillimisht, mazhoranca qeverisëse dukej e vendosur për të mos adresuar këtë problematikë, pasi mendonte se në këtë formë do të krijonte një avantazh për kundërshtarin politik, si dhe do të dobësonte pozitat e saj. Por, pavarësisht mungesës evidente të vullnetit, mazhoranca duket se u detyrua të dorëzohej përpara kauzës që bashkoi si rrallë më parë në të njëjtin front opozitën, faktorin ndërkombëtar, mediat dhe shoqërinë civile për të garantuar institucione publike imune ndaj personave me rekorde kriminale. Thelbi ishte prishja e kontrates së bërë mes politikës dhe personave me rekorde kriminale.

⁸ Proçesverballi i datës 14.09.2015, diskutimi i deputetit E. Halimi;

⁹ Proçesverballi i datës 20.11.2015, diskutimi i deputetit E. Halimi;

II. LIGJI DHE AKTET NËNLIGJORE TË MIRATUARA

20. Paketa ligjore që krijoi bazat për zbatimin e dekriminalizimit përbëhej nga tre akte të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, përkatësisht amendamentet kushtetuese, një ligj i posaçëm për dekriminalizimin dhe një vendim i Kuvendit për detajimin e rregullave procedurale. Në vijim, do të analizojmë përmbledhtazi parashikimet e secilit prej këtyre akteve. Pas miratimit në Komisionin e Posaçëm Parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë u mbledh në seancën plenare të datës 17.12.2015, për të miratuar Ligjin nr. 137/2015 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 8417, Datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar”. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 21.12.2015. Miratimi i amendamenteve kushtetuese, përveçse ishte një rekomandim i Komisionit të Venecias, ishte i detyruar pasi dekriminalizimi sillte një kufizim thelbësor të të drejtave politike, të sanksionuara në Kushtetutë.

21. Amendamentet kushtetuese përbëheshin nga katër dispozita. Ato përcaktonin ndalimin e zgjedhjes, emërimit apo ushtrimit të një funksioni publik në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, nëse verifikoheshin rrethana që çenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave që duhet të miratoheshin me ligj, me shumicë të cilësuar (shih nenin 1). Arsyeja pse ligji për dekriminalizimin duhet të bëhej me shumicë të cilësuar, është sepse zgjedhja apo emërimi i funksionarëve që ishin subjekte të dekriminalizimit, rregullohej me ligje me shumicë të cilësuar (tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit). Madje, në ligjin e dekriminalizimit ka një dispozitë të posaçme që në rastet kur ndërmjet këtij ligji dhe ligjeve të tjera ka konflikt, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi (shih nenin 16, të Ligjit nr. 138/2015). Qëllimi i këtij parashikimi ishte për të shmangur çdo lloj mundësie që funksionarë të caktuar t'i shmangeshin dekriminalizimit nëpërmjet mbrojtjes që mund të ofronin ligjet e tyre organike.

22. Në vijim, amendamentet kushtetuese përcaktonin ndalimin e zgjedhjes për shtetasit që janë dënuar me burg, me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ose para dhënies së një vendimi përfundimtar, si dhe në rastet kur janë dëbuar për një krim ose për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike. Në raste të caktuara, ligji mund të parashikojë edhe kufizime të të drejtës për të zgjedhur të shtetasve që janë duke vuajtur një dënim me heqje lirie (shih nenin 2). Ky ndryshim prekte pikërisht nenin 45 të Kushtetutës që garanton të drejtën e çdo shtetasi që ka mbushur moshën 18 vjeç për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Më tej, amendamentet parashikojnë një zgjerim të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese sa i përket shqyrtimit të rasteve kur mund të kemi funksionarë të zgjedhur apo të emëruar në kundërshtim me legjislacionin për dekriminalizimin. Kjo ishte një garanci qoftë për subjektet kushtetuese që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, ashtu edhe për subjektet e prekura që mund t'i drejtohen kësaj Gjykate për garantimin e të drejtave të tyre.

23. Amendamenti i fundit kushtetues ka të bëjë pikërisht me një diskutim të gjërë që ka zhvilluar Komisioni i Posaçëm Parlamentar nëse dekriminalizimi do të kishte efekt vetëm për të ardhmen, apo edhe për funksionarët që ishin aktualisht në detyrë. Pikërisht për t'i dhënë zgjidhje këtij diskutimi, u vendos që në Kushtetutë të parashikohej shprehimisht se filtri i dekriminalizimit do

të ishte i aplikueshëm edhe për funksionarët që ishin zgjedhur apo emëruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit. Me qëllim detajimin e mëtejshëm të kushteve, afateve, procedurave dhe verifikimit të ndalimit, dispozita parashikonte shprehimisht se Kuvendi duhet të miratonte brenda një afati 30-ditor ligjin për garantimin e integritetit të organeve që zgjidhen, emërohen ose mbajnë funksione publike (shih nenin 4). Proçeset eventuale që do të zhvilloheshin në Gjykatën Kushtetuese do të dëshmonin nevojën që kishte ligji i posaçëm për dekriminalizimin për të pasur një bazë solide kushtetuese, në të kundërt ligji mund të mos i kishte rezistuar testit të kushtetutshmërisë.

24. Në të njëjtën datë, me miratimin e amendamenteve kushtetuese, Kuvendi miratoi me shumicë të cilësuar ligjin nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*". Vetëm një ditë pas miratimit, Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani me dekretin nr. 9374 bëri shpalljen e ligjit, i cili më pas u publikua në Fletoren Zyrtare nr. 220, datë 22.12.2015, dhe hyri në fuqi në datën 06.01.2016. Ligji përbëhej nga 17 dispozita. Që në hyrje të tij del qartë qëllimi i legjislatorit për të garantuar besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve (shih nenin 1).

25. Zembrën e ligjit e përbëjnë pikërisht dispozitat që përcaktojnë kontrollin pas vetëdeklarimit të integritetit të funksionarëve publikë që janë subjekte të këtij ligji, veprat penale për të cilat aplikohet ndalimi dhe kohëzgjatjen e ndalimeve. Në listën e subjekteve janë përfshirë hierarkia më e lartë shtetërore, duke filluar nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministrat, deputetët, kryetarët e bashkive dhe të gjithë funksionarët e zgjedhur apo të emëruar nga Kuvendi. Po ashtu, në listën e subjekteve përfshihen edhe një kategori e zyrtarëve të lartë drejtues. Në listën e veprave penale përfshihen krimet shumë të rënda, krimet lidhur me korrupsionin dhe zgjedhjet e lira, dhe krime për të cilat parashikohet një dënim më i ulët, por që janë mjaftueshëm të rënda për t'u përfshirë në kategoritë e ndalimit (shih nenet 2 dhe 3). Ndalimet fillojnë nga dënimet përjetësisht, me 20 apo 10 vite, dhe më pas ulen në shkallë zbritëse në përputhje me parimin e proporcionalitetit (shih nenin 4). Ligji parashikon ndalimin e zgjedhjes apo emërimit edhe për ata persona që janë dënuar me vendime jopërfundimtare, janë marrë masa sigurimi, nxjerrë urdhëra arresti apo janë dëbuar nga vendet e BE-së, SHBA, Kanada dhe Australi. Arsyeja e përmendjes shprehimisht të këtyre shteteve ka të bëjë me standardin e sigurisë juridike, proçesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, që ato ofrojnë.

26. Në vijim, ligji ka përcaktuar mënyrën e fillimit të procedurës së verifikimit nëpërmjet plotësisht të formularit të vetëdeklarimit, i cili përmban të dhëna të plota sa i përket rekordeve hetimore, gjyqësore apo administrative që subjekti ka pasur në Shqipëri apo jashtë saj. Refuzimi për vetëdeklarim ose mosparaqitja e formularit përbën shkak për t'u aplikuar ndalimet për kandidim, zgjedhje apo emërim në një funksion publik. Deklarimi i të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe passjell përgjegjësi sipas Kodit Penal (shih nenin 5). Ligji ka detajuar se cilat janë subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar verifikimin e thelluar të të dhënave të subjektit të vetëdeklarimit, ku risia qëndron në parashikimin e të drejtës se 500 shtetasve me të drejtë vote për

të kërkuar verifikimin (shih nenin 7). Prokuroria e Përgjithshme është organi kompetent për të kryer verifikimin e të dhënave, duke përdorur një sërë mekanizmesh procedurale (shih nenin 8), përfshirë gjumët daktiloskopike.

27. Detyrimin për zbatimin e ndalimeve e kanë drejtuesit e institucioneve pranë të cilave dorëzohet formulari i vetëdeklarimit. Në rast se ato nuk veprojnë, 28 deputetë të Kuvendit mund t'i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese të konstatojë mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit (shih nenin 10). Kushtet e ndalimit aplikohen edhe për të zgjedhurit vendorë (shih nenin 11), si dhe për të gjithë funksionarët publikë që janë aktualisht në detyrë (shih nenet 13 dhe 14). Rregulla më të detajuara lidhur me afatet, plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, si dhe marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve do të miratohen me një akt nënligjor të Kuvendit (shih nenin 6). Së fundmi, ligji ka parashikuar detyrimin për publikimin në faqet online të institucioneve të formularëve, mosndikimin e këtij procesi në hetime apo gjykime në vazhdim, si dhe kohëzgjatjen e ndalimit për shtetasit që janë subjekte të masave nga shtete të huaja (shih nenin 16).

28. Dy muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 138/2015, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr. 17/2016 "*Për Përcaktimin e Rregullave të Detajuara mbi Zbatimin e Ndalimeve të Parashikuara në Ligjin nr. 138/2015*". Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 38, datë 10.03.2016. Vendimi është i përbërë nga gjashtë krerë, të cilët parashikojnë në mënyrë të detajuar afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, përmbajtjen, efektet dhe modelin e formularit të vetëdeklarimit, përmbajtjen e një kërkesë të një partie politike dhe modelin e formularit të kërkesës, procedurën se si realizohet verifikimi, dhe dispozitat e fundit që lidhen me krijimin e strukturave të posaçme apo caktimit të një personi përgjegjës për administrimin e formularëve; krijimin e regjistrit dhe detyrimin për publikim; si dhe detyrimin e Prokurorit të Përgjithshëm për krijimin e një strukture që do të kryejë procedurat e verifikimit (Drejtoria e Dekriminalizimit). Bashkëlidhur gjenden formulari i vetëdeklarimit dhe kërkesa për verifikim që bëhet nga kryetarët e partive për kandidatët.

III. ZBATIMI I DEKRIMINALIZIMIT

29. Miratimi i amendamenteve kushtetuese, akteve ligjore dhe nënligjore për dekriminalizimin ishte një zhvillim mjaft pozitiv për vendin, i cili u bë i mundur falë këmbënguljes së opozitës parlamentare, dhe mbështetjes së faktorit ndërkombëtar, veçanërisht Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, miratimi në letër do të ishte krejtësisht i pamjaftueshëm, nëse aktet do të cedonin në zbatimin e tyre. Në këtë kuptim, faza e zbatimit ishte kryesore për të arritur qëllimin e pastrimit të politikës dhe administratës publike, nga individë që në të shkuarën e tyre në vend të viteve të arsimit, kualifikimit, punës në profesionet e tyre apo në shërbim të komunitetit, kishin kryer krime nga më të rëndat. Në një shtet demokratik, individë të tillë gëzojnë të drejtën e rehabilitimit, por ata nuk mund të vishen me zhgunin e funksionarit publik për të marrë vendime për të ardhmen e fëmijëve, të rinjve, familjeve dhe njerëzve të ndershëm të vendit.

30. Me qëllim evidentimin e rezultateve konkrete që ishin arritur nga zbatimi i legjislacionit për dekriminalizimin, ne i drejtuam katër institucioneve me kërkesa për informacion, në mbështetje të neneve 3 dhe 11, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Konkretisht, me shkresën e datës 06.06.2023, iu drejtuam me kërkesën për informacion Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhur me numrin e funksionarëve në shërbimin diplomatik që janë larguar dhe funksionarëve që iu është ndaluar emërimi në një pozicion të caktuar për shkak të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 9590/1 prot., datë 16.06.2023, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, nuk ka pasur asnjë rast të funksionarëve në shërbimin e jashtëm që janë larguar apo iu është ndaluar emërimi për shkak të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit.

31. Në vijim, me shkresën e datës 06.06.2023, iu drejtuam me kërkesën për informacion Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (“KQZ”), lidhur me numrin e të zgjedhurve që janë larguar nga funksioni për shkak të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit; numrin e kandidatëve, të cilëve iu është ndaluar kandidimi për shkak të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit; numrin e të zgjedhurve dhe kandidatëve për të cilët KQZ-ja ka kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme; numrin e të zgjedhurve dhe kandidatëve, për të cilët ka rezultuar se kanë deklaruar të dhëna të rreme apo të pasakta; dhe informacion lidhur me trajtimin e rasteve të të zgjedhurve dhe kandidatëve për të cilët ka rezultuar se kanë deklaruar të dhëna të pasakta apo kanë fshehur të dhëna. Deri në datën e dorëzimit të këtij raporti nga KQZ-ja nuk pati asnjë përgjigje. Për shkak të kohës së kufizuar në dispozicion për përgatitjen e këtij raporti, nuk u ndoq procedura e ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

32. Megjithë përgjigjen e munguar, nga verifikimi i kryer nga ana jonë në faqen zyrtare të KQZ-së, ne konsultuam të dhënat e publikuara në raportet vjetore të veprimtarisë 2016 - 2021, të cilat në mënyrë të përmbledhur do t'i paraqesim në vijim. Në raportin vjetor për vitin 2016, rezulton se KQZ-ja, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ngriti strukturën e posaçme (Sektori i Dekriminalizimit), e cila pranoi, regjistroi me numër unik identifikimi çdo Formular Vetëdeklarimi, si dhe i skanoi duke i ruajtur elektronikisht ato. Me vendimin nr. 12, datë 20.05.2016, KQZ vendosi publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen e saj zyrtare. Në mbledhjen e datës 31.05.2016, KQZ shqyrtoi rastet e funksionarëve që nuk kishin depozituar formularin e vetëdeklarimit, përkatësisht: 12 këshilltarë bashkiakë e kishin dorëzuar pranë një organi tjetër; 13 këshilltarë bashkiakë e dorëzuan pranë KQZ-së jashtë afatit ligjor; dhe 18 këshilltarë bashkiakë refuzuan dorëzimin, çka solli që për ta të ndiqej procedura ligjore për heqjen e mandatit.¹⁰

33. Nga 140 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që dorëzuan formularin e vetëdeklarimit, rezultuan këto të dhëna: 121 deputetë nuk kishin asnjë të dhënë të shënuar; dhe

¹⁰ Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2016, fq. 27, 28 e raportit;

19 prej tyre kishin plotësuar të dhëna në një ose disa nga rubrikat në formularin e vetëdeklarimit. Ndërsa, nga 61 kryetarë bashkie rezultoi se: 50 prej tyre nuk kishin asnjë të dhënë të shënuar, ndërsa 11 prej tyre kishin plotësuar të dhëna në një ose disa nga rubrikat e formularit të vetëdeklarimit. Së fundmi nga 19 anëtarët e Këshillit të Ministrave, që nuk mbanin njëkohësisht mandatin e deputetit, nuk rezultoi asnjë e dhënë e shënuar në Formularin e Vetëdeklarimit apo në vërtetimet e gjendjes gjyqësore.¹¹ KQZ-ja pranoi të dhëna të shtesë nga subjekte të caktuara, duke vlerësuar se në çdo rast edhe nëse do të deklaroheshin nuk do të kishte pasoja për këto subjekte. Në rastet kur të dhënat e padeklaruara përbënin shkak për përfundimin e mandatit, KQZ-ja paraqiti kallëzim penal në Prokurori.¹²

34. Nga raporti vjetor i veprimtarisë për vitin 2017, rezulton se për zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, u depozituan listat shumëemërore të kandidatëve për deputet nga 18 parti, në total 2723 kandidatë. Këta të fundit depozituan, ndër të tjera, formularët e vetëdeklarimit. KQZ-ja kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historikun e gjeneraliteteve dhe gjendjen gjyqësore të tyre. Nga verifikimi i dokumentacionit për 2723 kandidatë, rezultoi se: 57 prej tyre kishin dënime me burgim me vendim të formës së prerë; ndërsa 2666 kandidatë nuk kishin deklaruar asnjë të dhënë që përfshihet në kushtet e ndalimit. Kandidatët, të cilët rezultuan me dënime me burgim me vendim të formës së prerë u zëvendësuan nga partitë politike propozuese brenda afateve ligjore.

35. Në shkurt 2017, Prokuroria e Përgjithshme kërkoi verifikim për dy deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. KQZ-ja vendosi t'ia përcjellë rastin Prokurorisë për verifikim të thelluar, e cila i përcolli rezultatet e verifikimit në datën 26.12.2017.¹³ Duke qenë se nga verifikimi i thelluar rezultoi se dy deputetë kishin fshehur të dhëna lidhur me hetimet, ndalimet dhe identitetet e përdorura në shtetit italian, në 5 janar 2018, KQZ vendosi shpalljen e pavlefshmërisë dhe përfundimin e mandatit të tyre.¹⁴ Gjatë vitit 2017, KQZ kreu verifikimin edhe për 79 kandidatë të listave shumëemërore për këshilltarë bashkiak, të cilët paraqitën formularët në kuadër të plotësimit të vakancave në këshillat bashkiakë. Nga informacionet e marra Drejtoria e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, si dhe nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, KQZ vendosi të lejonte vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit për 77 kandidatë, ndërsa 2 kandidatë u konstatuan në kushtet e moszgjedhshmërisë, çka bëri që t'iu ndalohej marrja e mandatit të këshilltarit bashkiak.¹⁵

36. Nga raporti i veprimtarisë për vitin 2018, rezulton se KQZ-ja kreu verifikimin e 76 rasteve, duke miratuar 27 vendime.¹⁶ Gjatë vitit 2018, KQZ-ja shqyrtoi 6 vendime "verifikim i thelluar", të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme. KQZ u shpreh me vendimmarrje për 5 raste,

¹¹ Po aty, në fq. 28, 29 të raportit;

¹² Po aty, në fq. 34 të raportit;

¹³ Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2017, fq. 54, 55 e raportit

¹⁴ Po aty, në fq. 55 të raportit

¹⁵ Po aty, në fq. 55, 56 të raportit

¹⁶ Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2018, fq. 19 e raportit

përkatësisht për 3 raste shpalli pavlefshmërinë e mandatit ose faktin e moskandidimit (2 deputetë, 1 këshilltar bashkiak), ndërsa për 2 raste të tjera vendosi se ish-deputetët nuk ishin në kushtet e ndalimit të ligjit nr. 138/2015.¹⁷ KQZ kreu verifikimin e 68 kandidatëve për këshilltarëve bashkiakë, në kuadër të plotësisht të vakancave të krijuara gjatë 2018. Pas administrimit të dokumentacionit, rezultoi se 4 kandidatë kishin dënime me burgim me vendim të formës së prerë, ndërsa 64 kandidatë nuk kishin asnjë të dhënë të tillë. Kandidatëve me vendime burgimi të formës së prerë iu ndalua vijimi i mëtejshëm i procedurave.¹⁸

37. Nga raporti i veprimtarisë për vitin 2019, rezulton se KQZ shqyrtoi rreth 400 vendime për verifikime për funksionarë publikë. Numri i lartë i vendimeve lidhet me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, si dhe dorëheqjet e deputetëve të subjekteve politike PD dhe LSI.¹⁹ KQZ kreu verifikimin për 46 kandidatë për deputetë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se 5 kandidatë për deputetë kishin dënime me burgim me vendime të formës së prerë. Megjithatë, ata nuk përfshiheshin në kushtet e ndalimit, të përcaktuar nga ligji nr. 138/2015.²⁰ Po ashtu, KQZ mori 134 vendimmarrje për moszgjedhshmëri për shkak të mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit, përkatësisht për 117 kandidatë të PD-së, 16 kandidatë të LSI-së dhe 1 kandidat i PS-së. Mosdorëzimi i formularëve nga kandidatët e PD – LSI lidhet me vendimmarrjen politike për braktisjen e Kuvendit.²¹

38. Gjatë vitit 2019, Prokuroria e Përgjithshme përcolli rezultatet e verifikimit të thelluar për tre raste. Një rast lidhet me një anëtar të Këshillit Bashkiak Mirditë, i cili megjithëse i dënuar me burg dhe gjobë, nuk rezultonte në kushtet e ndalimit. Ndërsa, dy rastet e tjera lidheshin me kryetarin e Bashkisë Vorë, dhe kandidatin fitues të Bashkisë Shkodër. Kryebashkiaku i Vorës rezultonte se nuk kishte deklaruar një urdhër arresti nga shteti grek, ndërsa kandidati fitues i Shkodrës nuk kishte deklaruar një dënim me 18 muaj burg për mbajtje të lëndëve narkotike nga shteti italian. Për kryebashkiakun e Vorës, KQZ vendosi se ishte në kushtet e ndalimit dhe shpalli përfundimin e mandatit, ndërsa kandidati fitues i Bashkisë Shkodër paraqiti dorëheqjen përpara marrjes së detyrës.²²

39. Zgjedhjet vendore të vitit 2019, ishin të parat gjatë të cilave u zbatua në tërësi kuadri ligjor për dekriminalizimin. Nga partitë politike u depozituan listat e kandidatëve, në total 10.153 kandidatë. Nga verifikimi i dokumentacionit të tyre, rezultoi se: 11 kandidatë kishin masa sigurimi personal; 6 kandidatë kishin dënime penale gjyqësore; dhe 5 kandidatë ishin hetuar/ndaluar nga organet ligjzbatuese. KQZ-ja refuzoi kandidimin për një kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë; 3 kandidatë që rezultuan me dënime gjyqësore penale, nuk ishin në periudhën e ndalimit të kandidimit, ndërsa 2 kandidatë që rezultonin të ndaluar, krimet nuk përfshiheshin në kategorinë e veprave penale që sillnin ndalimin e vijimit të kandidimit. Nga verifikimet e kryera për kandidatët për Këshillat Bashkiakë rezultoi se 277 kandidatë kishin vendime gjyqësore penale, nga

¹⁷ Po aty, në fq. 20 e raportit

¹⁸ Po aty, në fq. 21, 22 të raportit

¹⁹ Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2019, fq. 64;

²⁰ Po aty, në fq. 65 – 66 të raportit;

²¹ Po aty, në fq. 65 të raportit;

²² Po aty, në fq. 67 të raportit;

të cilët 236 nuk kishin deklaruar dënimet e mëparshme. KQZ refuzoi kandidimin për 11 kandidatë, ndërsa për 4 kandidatë fitues vendos faktin e moszgjedhshmërisë. 8 kandidatë fitues iu përcollën për verifikime të thelluara Prokurorisë pasi rezultoi me masa sigurimi personal ose hetime penale jashtë Shqipërisë.²³

40. Nga raporti i veprimtarisë për vitin 2020, rezultoi se KQZ ka administruar 83 formularë vetëdeklarimi për zëvendësimin e vakancave të krijuara në këshillat bashkiakë. Nga verifikimi ka rezultuar se këta kandidatë nuk ishin në kushtet e ndalimit, prandaj u lejua vijimi i mëtejshëm i procedurave për marrjen e mandatit. Ndërkohë që rezultoi se 38 kandidatë refuzuan dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit, duke sjellë edhe ndërprerjen e procedurave për marrjen e mandatit nga këta persona.²⁴ Gjatë vitit 2020, KQZ administroi verifikimet e thelluara të Prokurorisë së Përgjithshme për katër raste, duke vendosur përkatësisht pavlefshmërinë e mandatit të këshilltarit bashkiak për 1 rast; këshilltari bashkiak nuk ndodhet në kushtet e ndalimit në 1 rast; dhe për 2 raste të tjera përfundimin e procedurës pa vendim duke qenë se funksionarët kishin dhënë dorëheqjen.²⁵

41. Nga raporti i veprimtarisë për vitin 2021, rezultoi se KQZ ka verifikuar 1841 kandidatë për deputet, 66 kandidatë për këshillat bashkiakë, 2 deputetë dhe 2 anëtarë të Këshillit të Ministrave. Nga verifikimi ka rezultuar se 64 kandidatë për deputetë kishin deklaruar dënime/masa/dëbime, ndërsa 1777 kandidatë nuk kishin deklaruar asnjë dënim, dhe një kandidat rezultonte me masë në fuqi. Për 23 kandidatë, të cilët kanë qenë të dënuar/dëbuar jashtë vendit, KQZ kërkoi nga Prokuroria e Përgjithshme verifikim të thelluar.²⁶ Nga shqyrtimi i verifikimeve të thelluara nga Prokuroria e Përgjithshme, KQZ ka vendosur deklarin të përfunduar të procedurës pa vendim për 6 kandidatë për deputetë, duke qenë se ata rezultoi jofitues, si dhe për 2 këshilltarë bashkiakë, duke qenë se kishin dhënë dorëheqjen nga funksioni. Ndërkohë, që 4 kandidatë për deputetë dhe 1 kryetarë bashkie nuk ishte në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015.²⁷ Nga konsultimi me faqen zyrtare të KQZ-së rezultoi akoma i papublikuar raporti vjetor për vitin 2022.

42. Në mënyrë tabelare, funksionarë politikë të larguar nga dekriminalizimi janë:

Kategoria	Numri
Deputetë	9
Kryetarë bashkie	8
Këshilltarë lokalë	38
Totali	55

²³ Po aty, në fq. 69 të raportit;

²⁴ Raporti i veprimtarisë i KQZ-së për vitin 2020, fq. 25;

²⁵ Po aty, fq. 25 të raportit;

²⁶ Raporti i veprimtarisë i KQZ-së për vitin 2021, fq. 92 – 93;

²⁷ Po aty, fq. 95 e raportit;

43. Me shkresën e datës 06.06.2023, kemi kërkuar informacion nga Departamenti i Administratës Publike sa i përket numrit të nëpunësve civilë që janë larguar nga funksioni dhe nëpunësve që iu është ndaluar emërimi në një pozicion të caktuar për shkak të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit. Në përgjigje të kërkesës, me shkresën nr. 3037/1 prot., datë 13.06.2023, Departamenti i Administratës Publike ka përcjellë një informacion në formë tabelare, sa i përket numrit të nëpunësve civilë në administratën qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët janë liruar nga funksioni publik, pasi janë konstatuar në kushtet e ndalimit apo përjashtimit nga ky funksion, si dhe personave që iu është ndaluar emërimi në një pozicion të shërbimit civil në administratën shtetërore. Nga tabela rezulton se në periudhën 2016 – 2023, janë liruar nga funksioni publik 129 funksionarë, nga të cilët 87 specialistë, 28 përgjegjës sektori, 13 drejtorë drejtorie dhe 1 sekretar i përgjithshëm. Ndërsa, kandidatë të ndaluar për t'u emëruar në pozicionin e shërbimit civil rezultojnë 13 individë për kategorinë specialist.

44. Në vijim po paraqesim në formë tabelare informacionin e përcjellë nga DAP:

NËPUNËS CIVIL TË LIRUAR NGA FUNKSIONI PUBLIK									
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	
Specialist	18	23	23	7	6	3	2	5	87
P/Sektori	6	13	5	1	1	2			28
Drejtor	6	4	1		1	1			13
SP			1						1
Totali	30	40	30	8	8	6	2	5	129

KANDIDATË TË NDALUAR PËR T'U EMËRUAR NË POZICIONE TË SHËRBIMIT CIVIL NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE									
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	
Specialist			0		3	6	4		13
Totali	0	0	0	0	3	6	4	0	13

45. Megjithatë, për të pasur një panoramë më të plotë sa i përket efekteve të ligjit të dekriminalizimit në administratën publike, ne konsultuam edhe raportet vjetore të Departamentit të Administratës Publike. Kështu për vitin 2016, rezulton se 78 subjekte vetëdeklaruese kanë rezultuese në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik, nga të cilët 27 janë konstatuar nga

DAP dhe 51 subjekte nga Prokuroria e Përgjithshme.²⁸ Ndërsa, për vitin 2017 rezultoi se kanë rezultuar në kushtet e ndalimit 46 subjekte, nga të cilët 2 prej tyre janë konstatuar nga DPA, ndërsa 44 subjekte janë konstatuar nga Prokuroria e Përgjithshme.²⁹ Për vitin 2018, kanë rezultuar 70 subjekte në kushtet e ndalimit të parashikuara nga ligji nr. 138/2015.³⁰ Ndërsa, për vitin 2019 kanë rezultuar në kushtet e ndalimit 20 subjekte vetëdeklaruese.³¹ Edhe për vitin 2020 kanë rezultuar 20 subjekte vetëdeklaruese në kushtet e ndalimeve të ligjit për dekriminalizimin.³² Në raportin për vitin 2021, kanë rezultuar 13 subjekte në kushtet e ndalimit³³, dhe së fundmi për vitin 2022 kanë rezultuar 14 subjekte vetëdeklaruese në kushtet e ndalimit.³⁴

46. Në total 261 subjekte vetëdeklaruese janë konstatuar në kushtet e ndalimit të parashikuara nga ligji për dekriminalizimin. Vërehet qartë një mospërputhje ndërmjet të dhënave të dërguara me shkresë zyrtare në përgjigje të kërkesës tonë për informacion, dhe të dhënave të pasqyruara në raportet vjetore të Departamentit të Administratës Publike. Në formë tabelare të dhënat që rezultojnë nga raportet vjetore janë si më poshtë:

Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Totali
Numri	78	46	70	20	20	13	14	261

47. Me shkresën e datës 06.06.2023, kemi kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme sa i përket rasteve të trajtuara, gjetjeve që kanë rezultuar nga verifikimet, dhe trajtimin e mëtejshëm të këtyre rasteve në kuadër të zbatimit të ligjit për dekriminalizimin. Në përgjigje të kërkesës, me shkresën e datës 14.06.2023, Prokuroria e Përgjithshme ka informuar se përgjigjet gjenden të detajuara në “Raportin mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2022”, të publikuar të plotë në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme. Po kështu, edhe të dhënat për vitet e mëparshme që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit të dekriminalizimit dhe deri më sot, gjenden në raportet vjetore të cilat ndodhen në faqen zyrtare të Prokurorisë. Për këtë qëllim kemi konsultuar raportet vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme për periudhën 2016 – 2022.

48. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2016, rezultoi se në Mars 2016, Prokuroria krijoi Sektorin e Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrjnë Funksione Publike. Në bazë të verifikimeve të kryera nga ana e Sektorit të Prokurorisë së Përgjithshme, në fund të vitit 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ndërpreu mandatin dy deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, si edhe një të zgjedhuri vendor. Ndërkohë, në fillim të vitit

²⁸ Për më shumë shih: <https://dekriminalizimi.isp.com.al/index.php/2019/10/06/dap-2016-ne-kushtet-e-ndalimit-78-zyrtare-ose-4-5-e-numrit-total-te-subjekteve-vetedeklaruese/>

²⁹ Për më shumë shih: <https://dekriminalizimi.isp.com.al/index.php/2019/10/07/dap-2017-dhe-2018-ne-kushtet-e-ndalimit-124-zyrtare-ne-administraten-civile/>

³⁰ Për më shumë shih: <https://dekriminalizimi.isp.com.al/index.php/2019/10/07/dap-2017-dhe-2018-ne-kushtet-e-ndalimit-124-zyrtare-ne-administraten-civile/>

³¹ Për më shumë shih: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

³² Për më shumë shih: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

³³ Për më shumë shih: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

³⁴ Për më shumë shih: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

2017, Prokuroria e Përgjithshme konstatoi se edhe një tjetër deputet i Kuvendit të Shqipërisë ishte në kushtet e ndalimit për ushtrimin e funksionit, sipas përcaktimeve ligjore. Por ky subjekt, me funksion deputet, dha dorëheqjen pak para se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të shprehej me vendim lidhur me mandatin e tij. Pasi institucionet përgjegjëse sipas ligjit administruan formularët e vetëdeklarimit të subjekteve përkatës deri në datë 04.05.2016, në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën qershor-dhjetor 2016, janë administruar 650 raste për verifikim të thelluar. Për vitin 2016 janë marrë vendime për 327 subjekte vetëdeklarues të sjella për verifikim në vitin 2016. Nga këto për 225 raste, është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet në vitin 2016, dhe për 102 raste, përfundimet e rezultateve janë mbyllur në periudhën janar-shkurt 2017.³⁵

49. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2017, rezulton se Sektori i Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrijnë Funksione Publike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2017, ka administruar 563 raste për verifikim të thelluar. Gjatë kësaj periudhe, për 487 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit. Kërkesat e tjera prej 76 rastesh vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. E rëndësishme është të theksohet se në bazë të verifikimeve të kryera nga ana e Sektorit të Prokurorisë së Përgjithshme, në fund të vitit 2017, iu kërkua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërprerja e mandatit të dy deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe ky organ vendosi ndërprerjen e mandatit.³⁶

50. Për 136 subjekte, Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme ka vendosur se përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2. të ligjit nr.138/2015, si dhe Vendimit të Kuvendit nr.17/2016. - Për 30 subjekte ose 22 % e rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, gërma a) të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrijnë funksione publike”. - Për 24 subjekte ose 17,6 % e subjekteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, gërma b) të ligjit 138/2015. - Për 16 subjekte ose 11,7 % e subjekteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, gërma c) të ligjit 138/2015. - Për 55 subjekte ose 40,4 % e rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, gërma ç) të ligjit 138/2015. - Për 1 subjekt ose 0,7 % e rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 2, gërma a), të ligjit 138/2015. - Për 10 subjekte ose 7,35 % e rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të Vendimit të Kuvendit nr 17/2016 për arsye të mosdeklarimit të të dhënave në lidhje me të kaluarën e tyre kriminale.³⁷

51. Nga 487 vendime “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, të cilat ju janë njoftuar institucioneve përgjegjës, 252 materiale referuese për 252 subjekte, i janë dërguar për kompetence Prokurorive të Juridiksioneve përkatëse pasi kanë rezultuar, se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular, duke konsumuar veprën penale të “Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve” parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal. Për 250 raste është regjistruar procedim penal dhe për 2 raste është vendosur mosfillimi i procedimit. Nga këto

³⁵Për më shumë shih: https://www.pp.gov.al/rc/doc/raporti_pp_2016_07_03_2017_1160.pdf

³⁶Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2017, fq. 15

³⁷Po aty, në fq. 262;

250 raste, 18 procedime janë në hetim, 77 procedime janë pushuar dhe 154 procedime janë dërguar për gjykim. 1 procedim është pezulluar. Nga 154 procedime të dërguara për gjykim, 87 persona janë dënuar nga Gjykata, 35 raste janë ende në gjykim, për 7 raste është pushuar gjykimi, 19 raste janë transferuar, 6 persona janë shpallur të pafajshëm.³⁸

52. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018, rezulton se Sektori i Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrijnë Funksione Publike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2018, ka administruar 185 raste për verifikim të thelluar. Gjatë kësaj periudhe, për 147 subjekte vetëdeklaruese është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 30 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.³⁹

53. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2019, janë evidentuar përgjatë procesit të verifikimit nga ana e KQZ-së rreth 253 kandidatë të cilët nuk kanë deklaruar dënimet e mëhershme. Këta kandidatë rezultuan të dënuar apo të rehabilituar sipas të dhënave të gjendjes gjyqësore. Një pjesë e tyre janë zëvendësuar nga vetë subjektet politike përgjatë procesit të korrigjimit të dokumentacionit.⁴⁰ Lidhur me verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, gjatë vitit 2019, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar 204 praktika/kërkesa për verifikim, ka përfunduar 163 kërkesa për 15 subjekte të përfshirë në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione Publike” dhe për 148 subjekte që nuk përfshihen në këtë ligj, si dhe kanë mbetur në proces verifikimi 41 subjekte/kërkesa mbartur për vitin 2020.⁴¹

54. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2020, rezulton se janë regjistruar 109 procese të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji. Gjatë kësaj periudhe, për 163 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 41 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Lidhur me këto kërkesa/procese të regjistruara më vitin 2020, për 2 persona, kërkesat janë kthyer pasi nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në ligj ndërsa për 94 persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2020, duke miratuar rezultatet e verifikimit.⁴²

³⁸ Po aty;

³⁹ Raporti Vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2018

⁴⁰ Për më shumë shih: https://cec.org.al/ëp-content/uploads/2020/12/kqz_Fjala-e-Komisionerit-Shteteror-te-Zgjedhjeve-Illirjan-Celibashi-ne-tryezen-per-dekriminalizimin-1.pdf

⁴¹ Për më shumë shih:

https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Raportim_i_Prokurorit_te_Pergjithshem_mbi_gjendjen_e_kriminalitetit_per_vitin_2019_perpara_Kuvendit_te_Shqiperise18_06_2020.html

⁴² Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2019 përpara Kuvendit të Shqipërisë, datë 18.06.2020

55. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021, rezulton se janë regjistruar 181 procese të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji. Gjatë kësaj periudhe, për 118 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 63 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Lidhur me këto kërkesa/procese të regjistruara më vitin 2021, për 58 persona, kërkesat janë kthyer pasi nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në ligj, ndërsa për 60 persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2021, duke miratuar rezultatet e verifikimit.

56. Nga raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022, rezulton se janë regjistruar 111 kërkesa për verifikim të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji. Për 76 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 35 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr. 138/2015 dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Lidhur me vendimarrjen e vitit 2022, për 54 raste, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur mospranimin e tyre, për arsye të mosplotësimit të kushteve e kriterëve për verifikim të thelluar, të përcaktuara në ligj.

57. Në formë tabelare, në mënyrë të përmbledhur funksionarë publikë të larguar nga dekriminalizimi, sipas raporteve zyrtare të institucioneve publike dhe monitorimeve të organizatave të shoqërisë civile, për periudhën 2016 – 2023, rezultojnë si vijon:

Kategoria	Numri
Deputet	9
Kryetarë bashkie	8
Këshilltarë lokalë	38
Nëpunës civilë (DAP)	261
Nëpunës civilë të tjerë	281
Totali	597

IV. PROBLEMATIKAT DHE MANGËSITË

58. Krahas rezultateve domethënëse që pasqyruam më lart nëpërmjet shkresave dhe raporteve zyrtare të institucioneve të angazhuara drejtpërdrejt për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, procesi i dekriminalizimit njohu jo pak problematika dhe mangësi, të cilat kanë nevojë për t'u rikonsideruar për të ardhmen. Me qëllim evidentimin e këtyre problematikave, ne konsultuam edhe raportet periodike të dy prej organizatave që kanë qenë më aktivet në monitorimin e ecurisë së dekriminalizimit, përkatësisht Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Institutit të Studimeve Politike, si dhe artikuj të publikuar në media, veçanërisht BIRN dhe Zëri i Amerikës.

59. E ashtuquajtura kontratë e krimit me politikën ka hyrë në një fazë të re, e cila dikton nevojën e ndërhyrjeve ligjore për t'u çmontuar përpara instalimit përfundimtar në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2025. Kontrolli i thelluar i integritetit të aktorëve politikë, të atyre që kanë në dorë fatin e të zgjedhurve dhe të emëruarve, është thelbësor. Zbatimi i ligjit të dekriminalizimit solli në një pjesë të konsiderueshme largimin e individëve me rekorde kriminale nga ushtrimi i funksioneve publike, ndërkohë që parandaloi zgjedhjen apo emërimin e individëve të tjerë që mund të kishin këtë ambicie. Megjithatë, kjo nuk i pengoi këta individë që të vazhdonin të kishin një rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit. Standardet e sanksionuara në paketën ligjore të dekriminalizimit nuk u reflektuan më tej në çdo hapësirë publike, në mënyrë që asnjë individ me rekorde kriminale të mos diktonte vendimmarrjen politike. Angazhimi i ri i këtyre individëve u shpërfaq në disa modele, të cilat do t'i analizojmë në vijim.

60. Ish-funksionarët e larguar nga dekriminalizimi vazhduan të mbeten figura të rëndësishme në forcat e tyre politike. Siç rezulton nga raportet e organizatave të shoqërisë civile, në fushatat elektorale pati të dhëna të shumta se individët partiakë, që kanë humbur mandatin parlamentar ose postet ekzekutive për shkak të ligjit të dekriminalizimit, janë aktiv dhe madje drejtues kryesorë elektorale. Ata mbetën pikë referimi për median, kurse partitë e tyre respektive nuk reagues. Në rastin shqiptar imuniteti partiak lokal është shumë më i rëndësishëm sesa qenia deputet apo mbajtja e një posti drejtues ekzekutiv, për shkak se partitë kanë mbipushtet në administrimin politik dhe ekonomik të vendit. Fakti që ky imunitet lejohet, promovohet dhe nuk trajtohet me të njëjtin standard si në rastin e posteve politike e publike, tregon një defekt të ligjit të dekriminalizimit dhe një praktikë devijuese të partive nga standardet e premtuara të ligjit.⁴³ Standardi i dekriminalizimit do të duhej të rregullohej edhe në aktet e brendshme të partive politike (Statuti, Rregullore etj.).

61. Këta individë, së bashku me persona të tjerë, të cilët rezultojnë me rekorde të tmerrshme kriminale, janë ndër njerëzit më aktivë në fushatat elektorale. Ata përdorin paratë e fituara nëpërmjet aktiveve të paligjshme, përfshirë krime të rënda në vendet e BE-së, Mbretërinë e Bashkuar, vendet e Amerikës Latine, apo veprimtari korruptive nëpërmjet tenderave publikë në Shqipëri, për të blerë mbështetjen politike për kandidatët apo forcat e tyre politike. Blerja e votave, presioni i votuesve, kërcënimi i kandidatëve, sponsorizimi i mediave janë të gjitha mekanizma që

⁴³ Raport monitorimi "Zbatimi i legjisllacionit mbi dekriminalizimin në zgjedhjet parlamentare 25 prill 2021" fq. 61, 62;

kanë si financues pikërisht individë të botës së krimit. Këta individë janë përcaktues sot për të vendosur një familjar, të afërm, mik apo të njohur në listat fituese të partive politike. Madje, në zgjedhjet e fundit ata janë shfaqur publikisht përkrah kandidatëve apo në shtabet e tyre elektorale, duke kërkuar të maksimalizojnë rezultatin me çdo mjet.

62. Krahas ruajtjes së pozicioneve të forta në partitë politike, vendosjes së familjarëve apo të afërmeve në lista, mbështetjes së drejtpërdrejtë të kandidatëve, një tjetër mekanizëm i përdorur nga individët me rekorde të tmerrshme kriminale, është intervenimi në listat e partive të vogla politike, të cilat ia dalin që duke shfrytëzuar kushtet social-ekonomike në zona të caktuara, të marrin mandate deputetësh apo të zgjedhurish vendorë. Këta individë komandojnë përfaqësues me kontribute të papërfillshme a inekzistente në jetën publike apo partiake, megjithatë në disa raste ata ia kanë dalë të marrin më shumë vota se politikanë me një karrierë të gjatë, përfshirë ish-kryeministra, ish-ministra, ish-kryebashkiakë, ministra dhe deputetë në detyrë. Është e qartë se në këtë formë, individët me rekorde kriminale kërkojnë të ruajnë influencën e tyre mbi vendimmarrjen e institucioneve publike.

63. Mbështetja që individët me rekorde kriminale i japin partive politike nuk vjen aspak falas. Përkundrazi. Kontrata me krimin dikton detyrimin e funksionarëve që zgjidhen a emërohen në poste publike, që më pas të krijojnë lehtësira për kompanitë e këtyre individëve apo familjarëve të tyre, për të përfituar tendera publikë, konçesione, leje, liçenca dhe favorizime të ndryshme nga paratë apo pasuritë e taksapaguesve shqiptarë. Në disa raste, këta individë përfshihen drejtpërdrejtë si ortakë apo aksionarë në kompani, ku shteti zotëron pjesërisht pronësinë. Një pjesë e të ardhurave që krimi përfiton nga politika, ia kthen asaj më pas në zgjedhjet e ardhshme politike. Raportet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë OSBE/ODIHR, flasin për lumenj parash që kalojnë të pakontrolluara nëpër duart e kryetarëve të partive dhe kandidatëve të tyre gjatë proceseve zgjedhore.

64. Përveç kontrollit të thelluar të integritetit të kandidatëve, problematikat e mësipërme nxjerrin në pah edhe nevojën që kryetarët e partive, pra ata që vendosin për fatin e të zgjedhurve, të jenë subjekte të kontrollit. Një kryetar partie, që nuk ushtron një funksion publik nuk është sot subjekt i filtrit të dekriminalizimit dhe as ndonjë filtri tjetër për kontrollin e integritetit. Nga ana tjetër, asnjë kryetar partie nuk ka ndonjë përgjegjësi administrative dhe/ose penale nëse në listën e tij të kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie apo këshilltarë bashkiakë, përfshin individë me rekorde kriminale. Mungesa e çfarëdolloj përgjegjësie e kryetarëve të partive bën që ata të jenë të paimterësuar për të përjashtuar nga listat e tyre kandidatët që paraqesin probleme kriminaliteti në të shkuarën e tyre.

65. Megjithëse, ligji për dekriminalizimin iu ofron mundësinë partive politike që të kryejnë verifikimin e kandidatëve të tyre në periudhën jashtë zgjedhore, nga monitorimet që kanë kryer organizatat e shoqërisë civile rezulton se partitë politike nuk kanë interes për të verifikuar paraprakisht kandidatët e listave të tyre shumëemërore, duke mos kontribuar në drejtim të zbatimit

efektiv të legjislacionit të dekriminalizimit.⁴⁴ Kryerja e këtij procesi nga vetë partitë politike do të zgjidhte edhe një shqetësim të ngritur nga KQZ-ja sa i përket numrit shumë të madh të kandidatëve dhe kohës së shkurtër në dispozicion për të kryer verifikimet.⁴⁵ Kryerja e këtij procesi nga partitë politike do t'i jepte mundësi KQZ-së dhe Prokurorisë që të kishin kohën e nevojshme në dispozicion për të kryer verifikime të plota dhe për të çertifikuar pastërtinë e kandidatëve. Në këtë mënyrë garantohej që çdo subjekt politik do të paraqiste listë kandidatësh, mbi të cilët nuk rëndojnë hije dyshimi për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme brenda apo jashtë vendit.

66. Në zbatim të ligjit të dekriminalizimit, KQZ duket se vuan edhe nga mungesa e mekanizmave të duhur, burimeve njerëzore dhe një metode efikase verifikimi të thelluar, të shpejtë dhe të besueshëm.⁴⁶ Afati i shkurtër në dispozicion për të kryer verifikimet e nevojshme, sidomos në rastet kur kërkohet informacionet nga juridiksionet e huaja, dhe koha e gjatë që duhet për të pasur një përgjigje nga shtetet e huaja, është një shqetësim i ngritur publikisht edhe nga Prokurori i Përgjithshëm në raportimin vjetor përpara Kuvendit.⁴⁷ Shqetësimet e Prokurorit të Përgjithshëm kanë gjetur mbështetje edhe në qëndrimet publike të bëra nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili pranon se afati 3-mujor me të drejtë zgjatjeje është i ngushtë dhe jo i arsyeshëm.⁴⁸ Nëse verifikimet për një deputet zgjaten me 6 muaj deri në 2 vjet, atëherë qëllimi i arritur është gjysmak, pasi ai e ka shfrytëzuar detyrën e tij për një kohë të paarsyeshme, megjithatë nuk meritonte asnjë ditë që të vishte zhgunin e funksionarit publik.

67. Një çështje që ngeli pa u miratuar prej fillimit pasi u refuzua nga mazhoranca gjatë punimeve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar ishte edhe lista e shteteve të huaja, të cilat mund të kishin marrë masa të caktuara (vendim jopërfundimtar, masa sigurimi, urdhër kërkimi, dëbim), ndaj personave që ushtronin funksione publike apo që kërkonin të merrnin një funksion publik. Përjashtimi i vendeve të Amerikës Latine të njohura për nivelin e lartë të kriminalitetit u pa si një problematikë e ligjit. Megjithatë, ajo mbeti e paadresuar me arsyetimin se përcaktimi vetëm i vendeve të BE-së, SHBA, Kanada dhe Australi ka të bëjë me nivelin e standardeve që ofrojnë ato sa i përket shtetit të së drejtës, procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndërsa, arsyetimi tjetër lidhej me parashikimin e nenit 2, pika 6, të Ligjit nr. 138/2015, i cili përcakton se brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi do të miratonte listën e shteteve të tjera, masat e të cilave do të sillnin zbatimin e ndalimeve të këtij ligji.

68. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, rreth tetë vite, pasi është miratuar dhe hyrë në fuqi ligji për dekriminalizimin, akoma Kuvendi nuk ka miratuar listën e shteteve të tjera, vendimet apo masat e të cilave sjellin zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015. Kjo problematikë është evidentuar edhe nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat shprehen se: “Për pasojë, në çështjen e zbatimit integral të ligjit të dekriminalizimit është krijuar një

⁴⁴ Raport monitorimi “Zbatimi i legjislacionit mbi dekriminalizimin në zgjedhjet parlamentare 25 prill 2021” fq. 4;

⁴⁵ Për më shumë shih: <https://newsbomb.al/para-dhe-muskuj-klodiana-lala-ligji-i-dekriminalizimit-nuk-i-shkurajoi-partite-politike/>;

⁴⁶ Për më shumë shih: <https://www.reporter.al/2023/01/06/ligji-i-dekriminalizimit-deshtoi-ti-pastronte-partite-politike/>;

⁴⁷ Për më shumë shih: <https://www.zeriamerikes.com/a/7049101.html>;

⁴⁸ Po aty, në fq. 9 dhe 10;

problematikë, për shkak se në mungesë të kësaj liste të miratuar nga Kuvendi, vendet që nuk janë anëtare në BE si Zvicra apo Norvegjia, apo vende që mund të jenë në proces daljeje nga BE si Britania e Madhe, apo vende të shumta jashtë BE përfshirë disa në rajonin tonë, ku kemi raste të veprave penale, nuk janë ligjërisht vende në të cilat veprat penale janë objekt i veprimit të ligjit 138/2015⁴⁹.

69. Potencialisht, akoma sot mund të kemi funksionarë të lartë publikë që ushtrojnë detyrën apo që mund të zgjidhen a emërohen për të ushtruar një detyrë publike, të cilët kanë kryer vepra penale në shtetet që nuk parashikohen nga ligji nr. 138/2015. Kështu persona me rekorde kriminale në Britaninë e Madhe sot nuk janë të përfshira në listë. Mungesa e një baze të dhënash elektronike për personat me rekorde të tmershme kriminale në Britaninë e Madhe sjell natyrshëm mundësinë që ata të investojnë paratë e përfituara në mënyrë të paligjshme të takspaguesve britanikë. Këta individë mund të jenë në Shqipëri personat të respektuar për shkak të statusit pasuror, të hapin kompani, të marrin tendera publike, të bëjnë kontrata me politikën apo të bëhen vetë pjesë e saj. Ndaj, zgjidhja e kësaj çështje është një nga imediatet që do të rekomandohet më pas.

⁴⁹Për më shumë shih: <https://gazetasi.al/dekriminalizimi-ne-rrezik-kuvendi-nuk-ka-liste-per-vendet-ku-vepron-ligji/>;

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

70. Në tërësinë e tij, dekriminalizimi është një proces i suksesshëm, i cili solli largimin e rreth 600 funksionarëve të lartë publikë, përfshirë deputetë, kryetarë bashkie, këshilltarë bashkiakë, drejtues të rëndësishëm institucionesh, të cilët rezultonin me rekorde kriminale në biografitë e tyre. Por, si çdo proces tjetër, dekriminalizimi nuk mund të ishte i kulluar dhe i pagabueshëm. Problematikat që u evidentuan më lart dhe të tjera që do të trajtohen në trajtën e rekomandimeve në këtë seksion, dëshmojnë nevojën për të vazhduar punën për imunizimin e mëtejshëm të politikës ndaj krimit të organizuar dhe e individëve që e përfaqësojnë atë, të cilët pasi kanë kryer krimet ndër më monstruozet, tashmë kërkojnë të pastrojnë veten e tyre duke veshur petkun e politikanit, të biznesmenit apo bamirësit hipokrit që i qan zemra për shqetësimet e njerëzve të thjeshtë.

71. Rekomandimi i parë: Në zgjedhjet e fundit është vërejtur se ish-funksionarë publikë të larguar për shkak të procesit të dekriminalizimit persona me lidhje familjare apo miqësore për të vazhduar të ushtrojnë ndikimin e tyre në vendimmarrjen politike dhe institucionale. Personat që vihen në front të parë janë të panjohur, me pak ose aspak kontribute publike apo politike, dhe e vetmja “meritë” e tyre është lidhja me sponsorin me rekorde kriminale që iu rri nga mbrapa. Me qëllim adresimin e këtij shqetësimi, vlerësojmë se në ligjin nr. 138/2015, duhet të përfshihet koncepti i kontakteve të papërshtatshme, i njëjtë me atë që gjendet i sanksinuar në nenin DH të Kushtetutës dhe nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, për prokurorët dhe gjyqtarët. Kushdo që ka kontakte apo lidhje të qëndrueshme me elementë të krimit të organizuar nuk mund të vazhdojë të ushtrojë detyrën publike apo të zgjidhet në një funksion publik. Kjo do të kërkonte që procedura e verifikimit të shtrihet edhe më tej se vetëm subjekti i vetëdeklarimit, në rrethin e tij familjar apo miqësor. Është e papranueshme që një gjyqtar apo prokuror humbet funksionin e tij nëse ka kontakte me elementë të krimit të organizuar, ndërsa një deputet, ministër a kryetar bashkie mund të vazhdojë qetësisht detyrën e tij.

72. Pikërisht për këtë qëllim, ndryshimet ligjore duhet të përfshijnë detyrimin e funksionarëve publikë për të plotësuar deklaratën e kontrollit të figurës. Deklarata duhet të evidentojë të gjitha lidhjet, kontaktet, njohjet që funksionari mund të kenë me elementë të botës së krimit, përfshirë edhe natyrën, kohëzgjatjen, arsyen e këtyre kontakteve. Mosdeklarimi i një kontakti të papërshtatshëm, deklarimi i të dhënave të rreme apo të paplota, përbëjnë shkak që funksionari publik të shkarkohet nga detyra dhe të shkojë për ndjekje penale. Kjo përfshin fazën e vetëdeklarimit. Në fazën e verifikimit, kontaktet e funksionarit publik i nënshtrohen një kontrolli nëse janë të atilla që sjellin humbjen e funksionit. Aplikimi i testit të proporcionalitetit në këtë rast është thelbësor, pasi nuk bëhet fjalë për kontakte të rastësishme apo foto gjatë një aktiviteti politik, por për kontakte që qëndrueshme, që sjellin efekte në veprimtarinë e funksionarit. Një funksionar publik që shoqërohet me individë me rekorde kriminale dëmton rëndë besimin e publikut te institucionet.

73. Rekomandimi i dytë: Dekriminalizimi ka pasur për qëllim që të prekë jo vetëm jetën institucionale të vendit, por edhe jetën e brendshme të partive politike. Në këtë kuptim, mbajtja e

funksioneve drejtuese qëndrore apo lokale në partitë politike, të funksionarëve të larguar për shkak të procesit të dekriminalizimit, dëmton esencialisht pastrimin e politikës nga individë me rekorde kriminale. Për këtë arsye, është me vend që në ligjin për dekriminalizimin apo në ligjin për partitë politike të bëhen ndryshimet e nevojshme që detyrojnë partitë politike të përshtasin aktet e brendshme rregullatore me standardet e dekriminalizimit, duke përjashtuar nga funksionet drejtuese individë me rekorde kriminale. Sanksionimi i këtij standardi është veçanërisht i rëndësishëm për kryetarët e partive, të cilët për shkak të sistemit të centralizuar të vendimmarrjes që ekziston në subjektet tona politike, kanë një rol domethënës në caktimin e kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie, këshilltarë bashkie etj., por edhe emërimin e drejtuesve të lartë partiakë. Po ashtu, kryetarët e partive politike janë kanali më i shpeshtë nëpërmjet të cilit individët me rekorde kriminale kërkojnë të injektojnë paratë e paligjshme për financim të aktivitetit elektorale pasi është kryesori që mund të lidhë “kontratën” me ta dhe ka besueshmërinë e kërkuar prej tyre.

74. Me qëllim adresimin e këtyre problematikave, ndryshimet ligjore duhet të parashikojnë si subjekt të vetëdeklarimit të rekordeve kriminale dhe kontrollit të figurës kryetarët e partive politike. Këta të fundit duhet të deklarojnë jo vetëm veprat penale, dënimet apo masat e marra ndaj tyre, por edhe kontaktet që ata kanë me elementë të krimit të organizuar. Mosdeklarimi i të dhënave në mënyrë të saktë dhe të plotë, apo fshehja e të dhënave, përbën shkak që partisë politike t’i refuzohet apriori regjistrimi në zgjedhje nga KQZ-ja. Nëse kryetari i partisë rezulton se ka rekorde kriminale, që përfshihen në kushtet e ndalimit, apo kontakte të papërshtatshme, KQZ refuzon regjistrimin e subjektit politik në zgjedhje, deri në caktimin e një kryetari të ri. Në listën e dokumentacionit të përcaktuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor, mund të shtohet edhe një vërtetim që çertifikon integritetin e kryetarit të partisë.

75. Në vijim të linjës së rekomandimit të mësipërm, kryetari i partisë duhet të ketë përgjegjësi të drejtpërdrejtë edhe në rastet kur përfshijnë në listat e tyre individë me rekorde kriminale. Për këtë qëllim, ndryshimet ligjore mund të përfshijnë edhe detyrimin e kryetarit të partisë për të dorëzuar së bashku me setin e dokumenteve të parashikuara nga neni 64 i Kodit Zgjedhor, edhe një deklaratë që lista e kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie, këshilltarë bashkiakë nuk përmban individë me rekorde kriminale dhe se ai dhe subjekti që ai drejton e ka kryer këtë verifikim. Në fund të deklaratës të përshkruhet qartazi se ai mban përgjegjësi të plotë për të dhënat e përcjella dhe verifikimin e kryer. Mosparaqitja e kësaj deklarate përbën shkak për mosregjistrimin e partisë si subjekt zgjedhor, ndërsa paraqitja e saj me të dhëna të rreme do të passillte krahas mosregjistrimit, edhe përgjegjësi penale. Parashikimi i këtij detyrimi do të nxiste kryetarët e partive që të përdorin mekanizmin që parashikon ligji i dekriminalizimit për verifikimin e kandidatëve të tyre jashtë periudhave zgjedhore. Përveçse kjo do të garantonte kandidatë me integritet, kjo do të zgjidhte edhe shqetësimin e KQZ-së sa i përket numrit të lartë të formularëve dhe kohës së shkurtër në dispozicion për të kryer verifikimet.

76. Rekomandimi i tretë: Nisur edhe nga diskutimet e zhvilluara në Komisionin e Posaçëm Parlamentar, por edhe problematikës që ka lindur nga praktika, sa i përket listës së shteteve, dënimet apo masat e të cilave përbëjnë kusht ndalimi për zgjedhjen, emërimin apo ushtrimin e funksioneve publike, Kuvendi duhet të miratojë sa më shpejt të jetë e mundur

nëpërmjet ndryshimeve ligjore apo me vendim të tij, listën e shteteve që janë objekt veprimi i ligjit. Është tërësisht e papranueshme që individë që mund të kenë kryer vepra penale në Britaninë e Madhe, Zvicër, Norvegji (vende evropiane, jo anëtare të BE-së), apo edhe vende të tjera, mund të vazhdojnë qetësisht të ushtrjnë funksionet e tyre, të zgjidhen a emërohen në funksione publike për shkak të boshllekut ligjor. Debati i fundit që lindi në Britaninë e Madhe sa i përket kriminalitetit shqiptar e bën edhe më imediate nevojën e realizimit të këtij detyrimi ligjor.

77. Rekomandimi i katërt: Vështirësia e Prokurorisë për të kryer në një kohë të arsyeshme verifikimet e thelluara në rastet kur kërkohet ndihma e juridiksioneve të huaja është po ashtu një shqetësim i drejtë. Prandaj, me qëllim adresimin e kësaj problematike, një opsion zgjidhjeje mund të ishte krijimi i një regjistri elektronik të të dhënave për personat me rekorde kriminale të dënuar jashtë vendit, sipas secilit shtet e cila mund të aksesohet nga institucionet verifikuese. Ndërtimi i kësaj baze elektronike të dhënash me ndihmën e secilit shtet të përfshirë në ligj mund të bëhet sipas modelit të ligjit nr. 9614/2006 “Për Certifikatat Elektronike të Gjendjes Gjyqësore”. Kjo do të kërkonte një bashkëpunim ndër-institucional të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të vendeve të BE dhe ato jashtë saj në Tiranë. Në këtë mënyrë, verifikimi do të kryhej në një kohë të shpejtë dhe garantohej që askush mos t’i shpëtonte filtrit të dekriminalizimit për shkak të pengesave burokratike/procedurale.

78. Rekomandimi i pestë: Neni 3, gërma “g”, e ligjit nr. 138/2015 parashikon që subjekte të këtij ligji janë edhe personat që ushtrjnë apo kërkojnë të ushtrjnë funksione drejtues në kompani pronësi të shtetit, ku shteti është mazhoritar apo administrohen nga shteti. Megjithatë, për shkak të formulave të aplikuara vitet e fundit, vërehet se shteti po bëhet pjesë edhe e kompanive, ku është ortak apo aksionar minorance (rasti i Portit të Durrësit). Prandaj, në këtë kuptim, sugjerimi ynë është që çdo person që merr një funksion apo është ortak/aksionar në një kompani ku shteti është i përfshirë, duhet që t’i nënshtrohet filtrit të dekriminalizimit. Shteti nuk mund të pranojë kurrësesi që të jetë bashkë-ortak apo bashkë-aksionar me individë me rekorde kriminale, sepse në këtë rast do të kishin një shtet në ortakëri me krimin, që është mesazhi më i gabuar që mund t’i jepet opinionit publik dhe organeve ligjzbatuese. Funkionarët e lartë publikë duhet të largohen nga posti kur kanë nënshkruar kontrata publike (me fonde të Buxhetit apo të BE-së), me kompani që kontrollohen nga persona me rekorde kriminale, ose kur emërojnë administratorë të kompanive shtetërore, persona me rekorde kriminale.

VI. BIBLIOGRAFIA

A. Shkresat zyrtare

1. Shkresa nr. 1801/1 prot., datë 08.06.2023 e Kuvendit të Shqipërisë;
2. Shkresa nr. 9590/1 prot., datë 16.06.2023 e Ministrisë për Punët e Jashtme;
3. Shkresa nr. 3037/1 prot., datë 13.06.2023 e Departamentit të Administratës Publike;
4. Shkresa e datës 14.06.2023 e Prokurorisë së Përgjithshme.

B. Raporte

1. Raport monitorimi “Zbatimi i legjislacionit mbi dekriminalizimin në zgjedhjet parlamentare 25 prill 2021”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qershor 2021, gjendet në: https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/06/Raport-per-Dekriminalizimin_-Zgjedhje-Parlamentare-Prill-2021.pdf
2. Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2019 përpara Kuvendit të Shqipërisë, datë 18.06.2020, gjendet në: https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Raportim_i_Prokurorit_te_Pergjithshem_mbi_gjendjen_e_kriminalitetit_per_vitin_2019_perpara_Kuvendit_te_Shqiperise18_06_2020.html
3. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2022, gjendet në: https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_kriminaliteti_2022_Kuvendit_Prokuroria_e_Pergjithshme_6915.pdf
4. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2021, gjendet në: https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_Kuvendit_per_Kriminalitetin_2021_31_03_22_PP_6411.pdf
5. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2020, gjendet në: https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_2020_Kuvendit_Kriminaliteti_PP_5290.pdf
6. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2018, gjendet në: https://www.pp.gov.al/rc/doc/raporti_vjetor_2018_1571.pdf
7. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2017, gjendet në: https://www.pp.gov.al/rc/doc/raporti_vjetor_2017_1350.pdf
8. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2016, gjendet në: https://www.pp.gov.al/rc/doc/raporti_pp_2016_07_03_2017_1160.pdf
9. Dekriminalizimi Promovimi i Llogaridhënies së Zyrtarëve të Zgjedhur, gjendet në: <http://isp.com.al/ep-content/uploads/2021/11/ISP-NED-DEKRIMINALIZIMI-PROMOVIMI-I-ZYRTAREVE-TE-ZGJEDHUR-2020-2021.pdf>
10. ODIHR/OSBE: Raporti Përfundimtar mbi zgjedhjet lokale, Varshavë 28 shtator 2017, gjendet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/2/d/351226.pdf>

11. Dekriminalizimi: Gjendja, Problematika dhe Pritshmëritë, 2018, gjendet në: <http://isp.com.al/ep-content/uploads/2018/02/DEKRIMINALIZIMI-GJENDJA-PROBLEMATIKA-DHE-PRITSHM%C3%8BRIT%C3%8B.pdf>
12. Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2016,(pjesa për dekriminalizimin) gjendet në: <http://dekriminalizimi.isp.com.al/ep-content/uploads/2019/10/KQZ-RAPORT-MBI-DEKRIMINALIZIMIN-2016.pdf>
13. Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2017,(pjesa për dekriminalizimin) gjendet në: <http://dekriminalizimi.isp.com.al/ep-content/uploads/2019/09/KQZ-RAPORT-MBI-DEKRIMINALIZIMIN-2017.pdf>
14. Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 Janar – 31 Dhjetor për vitin 2018, (pjesa për dekriminalizimin) gjendet në: <http://dekriminalizimi.isp.com.al/ep-content/uploads/2019/09/KQZ-RAPORT-MBI-DEKRIMINALIZIMIN-2018.pdf>
15. Raporte nga DAP për vitet 2016-2022, gjenden në: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

C. Publikime

1. Ligji i dekriminalizimit 'dështoi t'i pastronte partitë politike', datë 06.01.2023, gjendet në: <https://www.reporter.al/2023/01/06/ligji-i-dekriminalizimit-deshtoi-ti-pastronte-partite-politike/>
2. Integriteti i zyrtarëve të lartë dhe standardet e dekriminalizimit (2022), datë 01.09.2023, gjendet në: <https://dekriminalizimi.isp.com.al/index.php/2023/01/09/integriteti-i-zyrtareve-te-larte-dhe-standardet-e-dekriminalizimit-2022/>
3. DAP 2017 dhe 2018: Në kushtet e ndalimit 124 zyrtarë në administratën civile, datë 07.10.2019, gjendet në: <https://dekriminalizimi.isp.com.al/index.php/2019/10/07/dap-2017-dhe-2018-ne-kushtet-e-ndalimit-124-zyrtare-ne-administraten-civile/>
4. DAP 2016: Në kushtet e ndalimit 78 zyrtarë ose 4.5% e numrit total të subjekteve vetëdeklaruese, datë 06.10.2019, gjendet në: <https://dekriminalizimi.isp.com.al/index.php/2019/10/06/dap-2016-ne-kushtet-e-ndalimit-78-zyrtare-ose-4-5-e-numrit-total-te-subjekteve-vetedeklaruese/>
5. "Dekriminalizimi", prokuroria has pengesa në hetimet jashtë vendit, datë 08.04.2021, gjendet në: <https://www.zeriamerikes.com/a/5845580.html>
6. Dekriminalizimi, Prokurori i Përgjithshëm: Vështirësi për të dhënat nga jashtë Shqipërisë, datë 13.04.2023, gjendet në: <https://www.zeriamerikes.com/a/7049101.html>
7. Fjala e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Ilirjan Celibashi në tryezën për dekriminalizimin, 11.12.2020 , gjendet në: https://cec.org.al/ep-content/uploads/2020/12/kqz_Fjala-e-Komisionerit-Shteteror-te-Zgjedhjeve-Ilirjan-Celibashi-ne-tryezen-per-dekriminalizimin-1.pdf
8. 'Para dhe muskuj', Klodiana Lala: Ligji i dekriminalizimit nuk i shkurajoi partitë politike, datë 26.04.2023, gjendet në: <https://neësbomb.al/para-dhe-muskuj-klodiana-lala-ligji-i-dekriminalizimit-nuk-i-shkurajoi-partite-politike/>
9. Gazetasi.al: "Dekriminalizimi në rrezik? Kuvendi nuk ka listë për vendet ku vepron ligji", datë 11.02.2020, gjendet në: <https://gazetasi.al/dekriminalizimi-ne-rrezik-kuvendi-nuk-ka-liste-per-vendet-ku-vepron-ligji/>

10. Reporter.al: Suksesi i pjesshëm i dekriminalizimit në luftën për pastrimin e politikës, gjendet në: <https://www.reporter.al/2020/02/03/suksesi-i-pjesshem-i-dekriminalizimit-ne-luften-per-pastrimin-e-politikes/>

VII. RRETH EKSPERTIT

Av. Eduard Halimi ka përfunduar studimet për drejtësi pranë Universitetit të Tiranës (1995), ndërsa më pas u diplomua me rezultate të shkëlqyera në Shkollën e Magjistraturës (2000).

Ai ka shërbyer si zëvendësministër i Drejtësisë (2005 – 2007), Avokat i Përgjithshëm i Shtetit (2007 – 2009), Deputet i Kuvendit të Shqipërisë (2009 – 2018) dhe Ministër i Drejtësisë (2011 – 2013). Gjatë mandatit të tij si deputet, ai ka mbajtur funksionet e sekretarit dhe nënkryetarit të Komisionit të Ligjeve, Komisionit të Reformës në Drejtësi, dhe nënkryetar i Grupit Parlamentar të PD-së. Ai ka qenë anëtar i Komisionit të Posacëm për Dekriminalizimin dhe një nga zërat më aktivë në Parlament dhe media sa i përket kësaj çështjeje.

Aktualisht, ai është drejtues i firmës ligjore “Halimi Law and Tax”, e cila fillimisht funksionoi në periudhën 2001 – 2005, për t’u rihapur sërish në mars 2018. Av. Halimi është ekspert i të drejtës private ndërkombëtare, të drejtës kushtetuese, autor librash dhe artikujsh në fushën e së drejtës.

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është institucion publik i Mbretërisë së Bashkuar që mbështet demokracine në të gjithë botën. Me shtrirje ndërkombëtare, WFD punon me parlamentet, partitë politike, Grupet e shoqërisë civile dhe me zgjedhjet që të ndihmojë t'i bëjë sistemet politike të shteteve më të drejta, më përfshirëse dhe llogaridhënëse.



www.wfd.org



[@WFD_Democracy](https://twitter.com/WFD_Democracy)



[@WestminsterFoundation](https://www.facebook.com/WestminsterFoundation)



Fondacioni Westminster për Demokraci është institucion ekzekutiv publik i mbështetur nga Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë, Komunellthin dhe Zhvillimin.

